



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**UDHËZIM
PËR**

**RREGJISTRIMIN E NJOFTIMIT TË VEPRËS PENALE DHE TË EMRIT TË PERSONIT
QË I ATRIBUOHET VEPRA PENALE¹**

Me synim,

- për të normuar rregjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe rregjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale;
- për të shmangur praktikën e gabuar dhe për të vendosur rregulla të njëjta për të gjitha Prokuroritë e ShkaUës së parë;

Në mbështetje, të nenit 24 pika 4, 287 e vijues të K. Pr. Penale dhe nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Rregjistrimi i njoftimit të veprës penale dhe rregjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale të kryhen me urdhër të veçantë të arsyetuar, sipas modelit bashkëlidhur. Urdhëri i dërgohet për veprim prokurorit ose punonjësit që mban regjistrin e procedimeve, i cili raenjëherë bën shënimet përkatëse në regjistër.

2. Prokurori urdhëron të shënohet në regjistër njoftimi për veprë penale pasi verifikon dhe vlerëson aktet që ka në dispozicion, për ekzistencën e elementëve thelbësorë të faktit dhe të elementëve të figurës së veprës penale.

2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe mund të bëhet një minimum verifikimesh, nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset rregjistrimi i procedimit.

¹ Shih, Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21. 11, 2005s i plotësuar me udhëzimin nr. 2, datë 24. 10. 2006

2.2 Në raste të veçanta, kur megjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar në pikën 2.1 të sipër përmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësorë të faktit dhe/ose të elementëve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të feprës penale të marr me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 20 ditë²,

3. Në rastet kur materjali i referimit të veprës penale nga policia gjyqësore shoqërohet me akte procedurale që përmbajnë atribuime për personin konkret, prokurori urdhëron si regjistrimin e njoftimit të veprës penale, ashtu dhe regjistrimin e emrit të personit.

3.1. Në rastet e kallëzimeve, fillimisht regjistrohet njoftimi për \reprën penale, nëse janë kushtet e pikës 2. Pasi administrohen aktet procedurale që i atribuojnë kryerjen e veprës penale personit, prokurori merr vendim për regjistrimin e emrit. Përmendja e emrit të tijë personi në një kallëzim nuk mund të shërbeje për regjistrimin e menjëhershëm të emrit në regjistër, pa u administruar më parë akte procedurale, në të cilat gjenden atribuime për personin konkret.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë prokurorët, ndërsa për të kontrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e të gjithë niveleve të prokurorive.

5. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara ne këte udhëzim, përbën shkelje të disiplinës në punë.

5. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokuroriife të të gjithë niveleve dhe punonjësit e caktuar për mbajtjen e regjistrit të procedimeve.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

Azhornoi KL
6.12.06

² Shih, pikën 1 të Udhëzimit nr. 2, datë 24. 10, 2006